REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr.8703prot. Lushnje, më 14/09/2026

RELACION

PËR NË KËSHILLIN BASHKIAK

PËR NJË SHTESË NË BUXHETIN E BASHKISË LUSHNJE PËR PROJEKTIN EUROPIAN 'SOILSTICE' - FORCIMI I INSTITUCIONEVE DHE NJËSIVE VENDORE PËR TRANSFORMIMIN E TOKËS, PËRFSHIRJEN DHE ANGAZHIMIN QYTETAR

Ky projekt ka për qëllim informimin dhe miratimin e pjesëmarrjes së Bashkisë Lushnje në projektin europian **"Strengthening Our Institutions and Localities for Soil Transformation, Inclusion, and Civic Engagement – SOILSTICE"**, me numër projekti **101297028**, financuar në kuadër të programit **Horizon Europe – HORIZON-MISS-2025-05-SOIL-09**.

Bashkia Lushnje është përcaktuar në Grant Agreement bashkë me partenerë të tjerë si **përfituesi me nr. 22 – BASHKIA LUSHNJE (LUSHNJA)**, dhe grant maksimal prej **55,000 euro**.

Projekti zbatohet për një periudhë prej **38 muajsh**, me datë fillimi **1 shtator 2026** dhe datë përfundimi **31 tetor 2029**.

Grant-i për Bashkinë Lushnje është parashikuar në buxhetin e projektit në shumën:

55,000 EUR – 100% financim i Bashkimit Europian

Financimi i projektit është parashikuar me normë **100%**, ndërsa Grant Agreement përcakton edhe kategoritë e kostove të pranueshme dhe rregullat për administrimin e tyre.

Për rrjedhojë, **Bashkia Lushnje nuk ngarkohet me bashkëfinancim financiar nga buxheti i saj për shumën e grantit prej 55,000 EUR**, sipas strukturës së financimit të përcaktuar në marrëveshje.

Projekti SOILSTICE synon të forcojë qeverisjen territoriale dhe pjesëmarrjen qytetare në menaxhimin e qëndrueshëm të tokës, duke përdorur **Territorial Management Agreements (TMA)** si instrumente të bashkëkrijuara ndërmjet bashkive, menaxherëve të tokës, fermerëve, qytetarëve dhe aktorëve të tjerë lokalë.

Në nivel europian, projekti parashikon krijimin dhe zbatimin e **40 marrëveshjeve territoriale (TMA) në 11 vende**, duke integruar indikatorë të shëndetit të tokës, si dhe mobilizimin e qytetarëve dhe forcimin e kapaciteteve të administratave vendore.

Adresa: Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 e-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

Projekti synon gjithashtu të lidhë praktikat lokale me politikat dhe instrumentet europiane në fushën e tokës, biodiversitetit, klimës dhe zhvillimit rural.

Bashkia Lushnje ka një pjesëmarrje formale në një projekt europian, ku është një prej autoriteteve vendore përfituese të projektit dhe do të angazhohet në proceset e **projektimit, zbatimit dhe monitorimit të Territorial Management Agreements (TMA)**.

Në kuadër të projektit, autoritetet vendore do të kalojnë përmes një procesi të strukturuar për përfshirjen në projekt, duke përfshirë:

- orientimin dhe trajnimin fillestar;
- përdorimin e mjeteve dhe metodologjive të projektit;
- përfshirjen e aktorëve lokalë;
- bashkëpunimin me fermerë, pronarë toke, shoqërinë civile dhe komunitetin;
- hartimin dhe zbatimin e proceseve pjesëmarrëse;
- monitorimin e rezultateve;
- shkëmbimin e eksperiencave me bashki të tjera europiane;
- dokumentimin dhe publikimin e rezultateve.

Pjesëmarrja në SOILSTICE është në interes të Bashkisë Lushnje për shkak të karakterit të saj të theksuar rural, bujqësor dhe territorial.

Projekti krijon mundësinë që Bashkia Lushnje të përfshijë në mënyrë më të strukturuar aktorët lokalë në çështje që lidhen me:

- mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së tokës;
- përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore;
- biodiversitetin;
- përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike;
- përfshirjen e fermerëve dhe komunitetit;
- rritjen e kapaciteteve të administratës vendore;
- zhvillimin e mekanizmave të rinj të bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë dhe komunitetit.

Një nga objektivat e WP4 të projektit është pikërisht zbatimi dhe monitorimi i TMA-ve, duke përdorur indikatorë të shëndetit të tokës, përfshirë lëndën organike, erozionin dhe biodiversitetin.

Përmes pjesëmarrjes në këtë projekt, Bashkia Lushnje përfiton:

1. **Financim europian prej 55,000 EUR** me normë financimi 100%.
2. **Rritje të kapaciteteve të stafit të Bashkisë**
3. **Trajnime dhe shkëmbim eksperiencash europiane**
4. **Përfshirje të komunitetit**
5. **Shkëmbim me bashki europiane**
6. **Rritje e vizibilitetit të Bashkisë**

Rezultatet e projektit do të dokumentohen dhe do të lidhen me **TMA Studio**, ndërsa projekti parashikon komunikim, storytelling, publikim të rezultateve dhe shkëmbim të njohurive.

Adresa: Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 e-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

Bashkia Lushnje sjell në territor një grant europian 55,000 euro, 100% të financuar nga BE-ja, dhe në këmbim forcon kapacitetet e administratës, përfshin fermerët dhe komunitetin dhe merr pjesë në një rrjet europian për menaxhimin e qëndrueshëm të tokës." Buxheti i miratuar e konfirmon shumën dhe strukturën 55,000 EUR.

DREJTORIA E PËRGJITHME E INTEGRIMIT, POLITIKAVE SOCIALE DHE INFORMIMIT

Ariola Korreshi

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI BASHKIAK
LUSHNJE

Nr.8703/1 prot.

Lushnje, më 14/09/2026

PROJEKT - VENDIM

Nr. 75 Datë 14/09/2026

PËR NJË SHTESË NË BUXHETIN E BASHKISË LUSHNJE PËR PROJEKTIN EUROPIAN 'SOILSTICE' - FORCIMI I INSTITUCIONEVE DHE NJËSIVE VENDORE PËR TRANSFORMIMIN E TOKËS, PËRFSHIRJEN DHE ANGAZHIMIN QYTETAR

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___/___/2026 pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e Integrimit, Politikave Sociale dhe Informimit "Për Regjistrimin e Projektit Europian 'SOILSTICE'– Forcimi i institucioneve dhe njësive vendore për transformimin e tokës, përfshirjen dhe angazhimin qytetar – SOILSTICE, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 neni 27, neni 54 gërma n "Për vetëqeverisjen Vendore", Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 neni 6, neni 15 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin nr. 68/2017 neni 6 gërma a, neni 10, neni 20 "Për financat e vetqeverisjes vendore", Ligji nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026" i ndryshuar, Ligjin Nr. 43/2016 "Për marrëveshjet Ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 775 pika 5, pika 13, pika 21 datë 24.09.2010 "Për administrimin e financimeve të huaja", i përditësuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 10, datë 12.07.2024 "Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozim të Kryetares së Bashkisë, Këshilli Bashkiak Lushnje,

PROPOZOJMË:

1. Miratimin e shtesës në buxhet të projektit Europian 'Soilstice' - Forcimi i institucioneve dhe njësive vendore për transformimin e tokës, përfshirjen dhe angazhimin qytetar në vlerën **55,000** Euro.
2. Buxheti i ndarë në kategori sipas Marrveshjes së Grantit.

(Kursi i këmbimit për llogaritjen e vlerës në ALL bazohet në Udhëzimin nr. 1 datë 02.06.2021 "Mbi mënyrën e llogaritjes së fiksit të kursit të këmbimit të Lekut në Bankën e Shqipërisë" i përditësuar)

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithme e Integrimit, Politikave Sociale dhe Informimit dhe Drejtoria e Financë – Buxhetit.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Drejtoria e Përgjithshme e Integrimit,
Politikave Sociale dhe Informimit
Ariola Korreshi

Drejtoria Juridike
Bedri Hida
P. Enejd Shamo

KRYETARI I BASHKISË
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE